



**VENDIM**

*Nr. 3, Datë 27.01.2016*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E  
LICENSËS PËR OPERIMIN E SISTEMIT TRANSMETIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “b”, 38; 53 pika 2 dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës, për miratimin e licensës së operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe draftin përkatës,

**Konstatohet se:**

- OST sh.a është subjekt i cili në pëmbushje të kushteve përkatëse, pajiset me licensë në ERE, siç parashikohet në nenin 53, pika 1 të ligjit në fuqi.
- ERE është organi përgjegjës për dhënien e licensës së Operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (neni 37 pika 2 gërma “b”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendos:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e licensës së Operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

